

## BULETINI 3 - MUJOR

Prill - Qershor  
2025

Skema Kombëtare  
2025: 71 mijë fermerë  
aplikues

Mbahet Komiteti i II  
i Monitorimit për  
programin IPARD III

250 MLN Euro Kredi të  
Butë dhe 30 MLN Euro  
Garanci Sovrane për  
bujqësinë

## TRYEZË E PËRBASHKËT DISKUTIMI PËR SEKTORIN E BUJQËSISË

Zhvillohet Tryeza e Përbashkët e Diskutimit, me pjesëmarrjen e Kryeministrit Edi Rama, ministrave të kabinetit qeveritar, kryetarëve të bashkive dhe 160 përfaqësuesve të biznesit nga i gjithë vendi duke përfshirë fermerë, blegtorë, agropërpunues, sipërmarrës në agroturizëm dhe përfaqësues të sektorit të peshkimit.

Në këtë tryezë u trajtuan çështje me rëndësi strategjike për të ardhmen e bujqësisë dhe zhvillimit rural në vend. Gjatë diskutimeve u dëgjuan problematikat dhe idetë e përfaqësuesve të sektorit, ndërsa u analizuan sfidat dhe mundësitë që lidhen me zhvillimin e bujqësisë.

Qëllimi kryesor ishte forcimi i koordinimit të nismave mbështetëse, për të rritur prodhimin “Made in Albania”, tashmë i pranishëm në mbi 80 tregje elitare ndërkombëtare, si dhe për të nxitur një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të bujqësisë në vend. AZHBR mbetet e angazhuar të bashkëpunojë ngushtë me aktorët e sektorit dhe të zbatojë skemat mbështetëse, me qëllim rritjen e aksesit në financë.



## TAKIMI I II-TË I KOMITETIT TË MONITORIMIT PËR PROGRAMIN IPARD III

Zhvillohet mbledhja e dytë e Komitetit të Monitorimit të Programit IPARD III, i cili luan një rol kyç në mbikëqyrjen e zbatimit të programit dhe funksionon sipas Marrëveshjes Financiare Kuadër dhe Marrëveshjes Sektoriale.

Në takim morën pjesë anëtarë të Komitetit të Monitorimit që përfaqësojnë: shoqata të sektorit bujqësor, partnerë ekonomikë, socialë dhe mjedisorë, përfaqësues nga ministri të tjera të linjës, strukturat e IPARD-it, Komisioni Evropian, Delegacioni i BE-së në Shqipëri dhe donatorë ndërkombëtarë. Gjatë mbledhjes u diskutua statusi i zbatimit të programeve IPARD në vendet

përfituese, funksionimi i sistemit të menaxhimit dhe kontrollit, progresi i kontrolleve dhe auditimeve, mbyllja e Programit IPARD II dhe hapat për zbatimin e Planit të Veprimit, Raporti Përfundimtar i Zbatimit të IPARD II (2014–2024) dhe Raporti Vjetor për vitin 2024, përgatitjet për masat e reja të IPARD III, ecuria e vlerësimit ex-post të programit dhe zbatimi i Masës së Asistencës Teknike për vitin 2025.

Programi IPARD synon të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe zonave rurale në Shqipëri, duke përmirësuar standardet e jetesës, zhvillimin ekonomik dhe përgatitjen e sektorëve për tregun konkurrues të Bashkimit Evropian.

## TAKIM ME BANKAT E NIVELIT TË DYTË MBI GARANCINË SOVRANE

Ministrja e Bujqësisë, znj. Anila Denaj, ministri i Financave, z. Petrit Malaj dhe drejtoresha e përgjithshme e AZHBR-së, znj. Ardita Kuçi zhvilluan një takim me drejtues të bankave të nivelit të dytë dhe përfaqësues të Shoqatës së Bankave, për të diskutuar detajet teknike të Garancisë Sovrane për sektorin e bujqësisë. Me një fond prej 3 miliardë lekësh, kjo skemë synon të lehtësojë aksesin në financë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, duke mbuluar deri në 70% të principalit të kredisë, me një shumë maksimale prej 25 milionë lekësh për subjekt.

Skema mund të kombinohet edhe me instrumente të Bankës së Shqipërisë, duke krijuar më shumë mundësi financimi për investime në bujqësi.



## TAKIME INFORMUESE MBI SKEMËN KOMBËTARE TË MBËSHTETJES 2025



Me hapjen e thirrjes për Skemën Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi 2025, stafi i MBZHR-së dhe AZHBR-së zhvilloi takime informuese në 12 qarqe të vendit.

Gjatë këtyre takimeve, fermerët u informuan në mënyrë të detajuar mbi masat mbështetëse, kriteret e përfitimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim. Ekspertët e AZHBR-së prezantuan masat që ofron skema, duke u përgjigjur pyetjeve dhe paqartësive të pjesëmarrësve. Qëllimi i këtyre takimeve ishte rritja e transparencës dhe lehtësimi i procesit të aplikimit për të gjithë fermerët e interesuar.



## 71 MIJË FERMERË APLIKUAN NË SKEMËN KOMBËTARE 2025



Aplikimet për Skemën Kombëtare 2025 u mbyllën më 30 maj, duke regjistruar 69 mijë aplikime, të përbëra nga 71 mijë fermerë nga i gjithë vendi, për tetë masa mbështetëse.

Procesi i vlerësimit administrativ dhe në terren vijon në përputhje me kriteret dhe rregullat e përcaktuara në skemë, sipas afateve të parashikuara.

Skema Kombëtare 2025 ofron mbështetje përmes tetë masave subvencionuese për: blegtorinë, bletarinë, farat dhe fidanët, bimët mjekësore-aromatike, fermat organike, certifikimin Global GAP, si edhe naftën për punimet e mekanizuara në bujqësi.

Kjo skemë synon rritjen e bashkëpunimit mes fermerëve dhe uljen e kostove duke ndihmuar fermerët të rrisin produktivitetin dhe cilësinë e prodhimit vendas.



## AZHBR PJESËMARRËSE NË KONFERENCËN E 57-TË TË AGJENCIVE TË PAGESAVE



Drejtoresha e Përgjithshme e AZHBR, znj. Ardita Kuçi, mori pjesë në Konferencën e 57-të të Drejtorëve të Agjencive të Pagesave të BE-së, zhvilluar në Varshavë, në kuadër të Presidencës Polake të Këshillit të BE-së.

Konferenca mbledhi përfaqësues nga agjencitë e vendeve anëtare dhe kandidatë të BE-së, si edhe të Komisionit Evropian, Gjykatës Evropiane të Auditorëve dhe Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF). Në fokus ishin teknologjitë moderne në bujqësi, si dronët për spërkatje, sistemet autonome bujqësore, si dhe përvoja kërkimore në mjekësinë veterinare dhe bioteknologji.

Pjesëmarrja e AZHBR-së thekson angazhimin për përmirësimin e menaxhimit të fondeve bujqësore dhe forcimin e bashkëpunimit me vendet e BE-së.



## AZHBR MERR PJESË NË KONFERENCËN E 63-TË TË PANTA RHEI NË HOLANDË

Drejtoresha e Përgjithshme e AZHBR-së, znj. Ardita Kuçi, mori pjesë në Konferencën e Panta Rhei në Leiden, një forum kyç për agjencitë paguese të BE-së mbi politikën bujqësore dhe inovacionin teknologjik.

Në prezantimin e saj, znj. Kuçi ndau përvojat e Shqipërisë në përdorimin e inteligjencës artificiale në shërbimet publike, përfshirë platformën e-Albania dhe asistentin dixhital, si shembuj të suksesshëm që e pozicionojnë Shqipërinë si një shembull inovator në përdorimin e inteligjencës artificiale.

Konferenca trajtoi edhe çështje si siguria e informacionit, përdorimi i dronëve dhe administrimi digjital i parcelave. Pjesëmarrja e AZHBR-së nënvizon angazhimin për digjitalizimin dhe përputhjen me standardet më të avancuara të BE-së në mbështetjen e bujqësisë.





## MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT TË VRESHTARISË

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, znj. Anila Denaj, dhe Drejtoresha e Përgjithshme e AZHBR-së, znj. Ardita Kuçi, zhvilluan një takim me përfaqësuesit e Shoqatës Shqiptare të Verës, ku u diskutuan mundësitë e financimit dhe zhvillimit të këtij sektori strategjik. Gjatë takimit u prezantuan mundësitë konkrete të financimit për zhvillimin e sektorit të vreshtarisë dhe verës, përmes përfshirjes në Skemën Kombëtare të Investimeve 2025–2026,

që synon shtimin e sipërfaqeve të mbjella dhe instalimin e sistemeve moderne të ujitjes me pika.

Po ashtu, u theksua edhe mbështetja për agropërpunimin, përmes financimit të linjave, makinerive dhe pajisjeve për përpunimin, seleksionimin, paketimin dhe etiketimin e rrushit dhe verës. Në fokus të diskutimeve ishin edhe dy instrumentet kryesore të aksesit në financë: Kredia e Butë dhe Garancia Sovrane.

## DREJTORESHA E AZHBR NË INTERVISTË PËR ABC NEWS

Drejtoresha e Përgjithshme e AZHBR-së, znj. Ardita Kuçi, në një intervistë për ABC News, informoi mbi dy instrumente shumë të rëndësishme financimi për sektorin e bujqësisë: Garancinë Sovrane dhe Skemën e Investimeve.

Përmes Skemës Kombëtare të Investimeve, e cila ofron grant 50% dhe mbështetjes nga Kredia e Butë e kombinuar me Garancinë Sovrane, fermerët dhe bizneset në bujqësi mund të përfitojnë financim me normë interesi vetëm 2%, si dhe mbulim kolaterali deri në 70%.

Këto masa synojnë të fuqizojnë sektorin e bujqësisë duke mundësuar akses më të mirë në financime dhe zhvillim të qëndrueshëm.

